

PETRAQ I. ZOTO



MESUESI IM I PARE



PETRAQ ZOTO

MËSUESI IM I PARË

*(Tregime për fëmijët e moshës së re dhe të
mesme shkollore)*

~~38404~~
14489

SHTËPIA BOTONJËSE «NAIM FRASHËRI»



MËSUESI

IM

I PARË

E kujtoj shumë herë mësuesin tim të parë.
E kujtoj dhe mallëngjehem. Ne e donim dhe e
respektonim shumë.

Ai ish një burrë me trup mesatar, i hequr
në fytyrë. Nuk ish plak, po flokët i qenë zbar-
dhur. Mbante një palë syza me xham të tra-
shë. Ish i ngadalshëm në të ecur dhe shumë
i kujdesëshëm në çdo punë. Veç ta shihnit me
sa durim e rregull i ndreqte detyrat! Kurrë nuk
thërriste, fliste shtruar e të bënte ta dëgjoje me
gojë hapur.

Vetëm atë mësues kish fshati dhe ai punon-
te me të pesë klasat. Dhoma e mësimit ish e vo-
gël e s'na merrte të gjithëve. Dy klasa mblidhe-
shin për mësim pas dite, të tjerët para dite.

Kështu atij i duhej të punonte shumë. Ne
e shihnim që lodhej. Shpesh herë ulej në karri-

ke, mbështeste brylat në tavolinë e mblihte vetullat me mundim. Nganjëherë ish i verdhë në fytyrë e kollitej, po mësimin s'e linte kurrë.

Ai jetonte filli vetëm. Në qytet shkonte vetëm në kohën e pushimeve. Nxënësit e klasave të larta vinin e ndihmonin në shtëpi, vajzat fshinin dhomën e i mbushnin ujë, djemtë i prisnin dru. Fshatarët ja plotësonin menjëherë nevojat që kish. Ai ish i dashur e i sjellshëm me të gjithë dhe të gjithë e donin shumë. Ne ishim mësuar aq shumë me të sa që nuk e merrnim dot me mend që një ditë mund të ndaheshim.

Por e solli rasti të ndahemi fare papritur.

Ishte vjeshtë. Koha ish e vrejtur. Rrallë hapej qielli, vetëm disa çaste. Retë dendëshin prap dhe dukej sikur ish mbrëmje.



Kishim bërë 3 orë mësim. Orën e fundit kishim këngë.

Nuk kishim për të mësuar ndonjë këngë të re. Përsëritëm ato që dinim dhe pastaj mësuesi tha:

— Kush di ndonjë tjetër?

— Di unë një, zoti mësues — u hodh e tha Maqua i Ristos, që kish një zë të bukur e që mësonte këngët me një të dëgjuar.

— Pa hë, ta dëgjojmë njëherë.

Maqua u ngrit më këmbë, u koll një herë, e pastaj ja mori:

«Bashkohu shok' me ne në çetë,
malit të lartë të shkojm' përpjet. . .

— Këtë e dimë edhe ne! — thanë ca të tjerë.
Mësuesi nuk foli, po bëri shenjë që të fillonim të gjithë dhe vetë mbajti vesh.

«. . . Se atje, o shokë, kemi foletë

Ne shqipo, shqiponjat partizan'. . .»

Klasa buçiste. Mësuesi qeshte e vetëm lozte dorën.

Kur mbaruam këtë këngë, si e pa se mësuesit iu bë qejfi, u ngrit edhe Tirka:

— Edhe unë di një këngë. A ta këndoju?

Dhe filloi;

«Ato maja rripa-rripa seç gjëmojnë
ndizet lufta për liri

dhe derdhet gjak. . .»

Mësuesi përsëri dëgjonte me vëmendje e

ne të tjerët, që e dinim të gjithë atë këngë, ja muarëm pa na thënë njeri:

«Janë trimat partizanë që luftojnë,
janë bijt' e Shqipëris' që marrin hak. . .»

Veç të ishit atje e të dëgjonit se sa me qejf këndonim! Sidomos për vargun: «Janë trimat partizanë që luftojnë. . .» ishim gati të shkullnim mushkëritë.

Mësuesi ynë nuk ndenji më duke dëgjuar, po erdhi pranë nesh edhe ja mori edhe ai.

Atëhere ne s'mbaheshim fare!

Asnjë këngë nuk kishim kënduar aq me shpirt! Asnjë këngë nuk na i kish ndezur fytyrat si ajo! Këndonim me sa fuqi kishim. Dhe kur këndon me shpirt, kënga del e fuqishme e plot zjarr. Të duket se fluturon bashkë me të, në mal a në fushë, në luftë e në zjarr, atje ku ajo të thërret.

Po akoma nuk kishim mbaruar këngën, kur dera e shkollës u shty me forcë dhe brenda hynë me rrëmbim tre burra trupmëdhej. Të tre ishin të armatosur.

Burrat që hynë mbanin rroba shajaku. Njeri prej tyre kish varur në sup një automatik të ri, ndërsa të tjerët mbanin pushkë të gjata: në bres kishin ngjeshur nga një gjerdhan plot me fishekë e nga një revole të madhe. Në kapelat pa strehë u dallohej që atje tej zhga-

ba e madhe dykrerëshe. Fytyrat i kishin të vrejtura e vështrimin të egër.

Kur hodhëm sytë nga dritaret, pamë se oborri dhe rrugët po mbusheshin me njerëz të tillë të armatosur.

E ndaluaam përnjëherësh këngën, dhe, të trembur, shikuam mësuesin. Ai mbeti një copë herë si i ngrirë, pastaj u tha atyre:

— Zotërinj, ju lutem, pse hyni kështu pa trokitur? Unë nuk lejoj. . . nuk lejoj, jam në mësim.

— Të tillë mësim bën ti, edepsëz?

— Zotrisë tënde kush i dha të drejtë të më fyejë? Ç'je ti që kërkon llogari?

Mësuesi i tha këto fjalë me një zë që nuk ja kishim dëgjuar ndonjëherë dhe po dridhej nga inati. Kurrë nuk e kishim parë kaq të zemëruar!

— Ç'farë jam unë? Ne të gjithë jemi nacionalistë! — tha i krekosur burri hijerëndë, që mbante automatik.

— Shumë mirë, edhe ne për lirinë e popullit po këndojmë, a nuk dëgjoni? — tha mësuesi duke ngritur supet sikur nuk e kuptonte përse të mos u pëlqente kjo këngë.

— Kjo këngë që këndon ju, është për lirinë e komunistëve. Ne nuk e duam një liri të tillë!

— Ndryshe, pra, qënka liria juaj?

— Nepërkë! Bën sikur nuk kupton. . . Dhe

ma paske atë gjuhë brisk. Lidheni! — urdhëroi burri hijerëndë, i cili, siç na thanë më vonë, ishte komandant i Ballit për atë zonë.

Dy të tjerët ja lidhën mësuesit duart prapa dhe zunë ta shtynin për nga dera.

— Zotërinj. . . përse kjo? Dua ta di shkakun. . .

— E dimë ne!

— Të paktën më lini sa të përshëndetem me nxënësit e mij.

Nuk e lanë të mbaronte fjalën. Njeri e shtyu me kondak dhe mësuesi desh u rrëzua. Para se të kalonte pragun e derës, ktheu kokën nga ne e tha duke buzëqeshur:

— Lamtumirë, nxënësit e mij të dashur. Ju mësoni e këndonni këngë të tilla. . . Ato janë të vërteta! Më kuptoni? Të vërteta!

Ai dolli i shtyrë nga ballistët. Ne zumë të qanim.

— Pushoni! — thërriti ballisti. — Mësuesi juaj do ta gjejë vendin. Edhe ju, po të këndonni tjetër herë këngë të tilla, do t'ju thërrim të gjithëve si keca, dëgjuat? Tashti hajt, në shtëpi! Shporruni, mistreca!

Ikëm kokëvarur. Mëndjen e kishim te mësuesi. Na vinte keq për të. Çuditësim se si e muarën ashtu papritur.

Që atë ditë nuk vajtëm më në shkollë, dhe mësuesin s'e pamë më, po këngë partizane mësuam edhe shumë të tjera.



RRUGA E JETËS

Kur isha i vogël, fshati ynë ndodhej buzë kënetës. Them «kur isha i vogël», se atje ku ish kënetë, ose gjoli, siç i thoshim ne, tani rritet misri më tepër se shtati i njeriut. Fshati ish i madh, me shtëpi kashte e shavarr kënete. Vetëm shtëpia e beut ish e madhe e me oxhak. Fshati ynë ish çiflig i tij. Ai nuk lejonte që fshatarët t'i bënin shtëpitë me oxhak. Dhe beu ish bej — a mund t'i kundërshtojë? Për çdo gjë atij i pëlqente të thoshte: «Kjo është e imja» — dhe i vriteshin sytë kur shihte ndonjë fshatar me rroba të reja e të krekosur.

Kështu pra, fshatarët rronin si mos më keq, disa prej tyre banonin në një kasolle bashkë me bagëtinë.

Ne kishim një shtëpi të vogël, të mbuluar me shavarr ¹⁾. Babai im punonte tokën e beut.

1) Bimë që rritet në kënetë.



Ai ish edhe merakli pas peshkimit. Ditën punonte në arë e natën zinte peshq.

Njëherë iu qepa pas dhe ai më mori, sado

që isha shumë i vogël. Q'atëhere më hyri në zemër gjuetia e peshkut. Më pëlqente shumë llapashitja e lopatave të varkës në ujë. Na duhej të mbanim qetësi të madhe dhe, kur kish hënë, unë ëndërroja me sy hapur. Më dukej sikur ja, do më delte ai peshku i artë, që di të flasë si njeri e që mund të të japë një mijë të mira!

Herë pas here ditën edhe unë merrja grepin, i vija një krimb dhe e hidhja në gjol. Dhe isha i lumtur, shumë i lumtur kur më ecte fati dhe zija peshk. S'ka ankth më të madh, se sa të presësh gjersa peshku ta lozë perin! S'ka kënaqësi më të madhe se sa të shohësh peshkun, që ke flakur në tokë, kur përpëlitet, dhe kthen barkun e bardhë e të ndritshëm!

U sëmura një ditë dhe nuk vajta me bagëti (unë ruaja viçat e beut). Afër mbrëmjes e nxehta m'u ul. E ndjeva vehten mirë. Rrëmbeva grepin dhe vrapova në gjol. U ula mbi një gur. Aty afër gurit, ku isha ulur unë, ndodhej një shelg lotonjës i madh. Degët e tij arrinin deri në ujë. Nëpër këto degë se ku ish fshehur një bilbil që këndonte me ëmbëlsi. Lule llojesh kish anë kënetës dhe era e tyre më gulduliste. Nga luadhet e gjëra që shtriheshin pak më tej, vinte kundërmimi i barit të njomë.

Dielli ishte më të perënduar. Rrezet e tij

shkisnin tërthorazi përmbi kokën time dhe tut-
je faqja e ujit të qetë ndriste si pasqyrë.

Sa bukur që ish!

Kisha mbushur një tas cingoje me ciroj
të mëdhej. Megjithatë s'më ikej dhe isha si i
dehur nga kënaqësia.

Befas, prapa krahëve dëgjova hapa kuajsh,
kërceva përpjetë i trembur. Kur u ktheva të
shoh, koka ime sa nuk u përplas me atë të një
kali të madh, që mezi mbajti këmbët mu për-
para meje. Kali kafshonte hekurin e frerit
me gojën të mbushur me jargë. Pas tij ish
edhe një tjetër.

Ish beu me kapedanin e tij, Milen.

— Ç'po bën këtu, mor spurdhjak?! — m'u
shkreh ai.

— Hiç... ja...

— Si hiç... Që tashi po mësohet të gënje-
jë, far' e keqel!

— Ç'i ke këto? Prandaj s'vajte me viçat
sot, që të zesh peshq?! Nuk e di ti se kënetat
është imja? — Si heshti një hop, shtoi:

— Hm, yt atë s'paska vënë mend!

Zura të dridhesha. Harrova t'ju them se
beu e kish bërë mall edhe gjolin. Që të zije
peshk, duhej të merrje lejë prej tij. Babai nga-
njëherë merrte edhe lejë, mirëpo qëllonte që
nuk zinin dot as aqë peshk sa duhej t'i jepnim
beut për të na lejuar! Prandaj më tepër vinim
natën, fshehur.

Beu s'po m'i hiqte sytë e mënt më rrëzonte në gjol me atë kalin e tij të harlisur.

— Merrja peshqit, Mile! Merrja edhe grepin dhe futi një kokës, që ta mbajë mend. Po të pashë më, o zuzar, të hodha në gjol! — kithi ai.

Milja fët e fët e kreu urdhërin e beut.

Pastaj i kthyen kuajt nga luadhet dhe ikën me të katra. Unë mbeta në këmbë fare i shastisur. Aq e papritur kish qenë kjo ngjarje, sa më dukej sikur kisha parë ëndërr. Po peshqit nuk ishin më aty, as tasi, as grepi. Fillaova të qaja me dënësë dhe u ktheva në shtëpi.

E mos e kuptoj Todi de me nate.
— Ngeur, bir, i the qnë do të shkoj në arsë.
Kij kujdes e mos u largo nga shtëpia.
Ajo u nis. Todi e dinte se ç'duhet të bënte.
E shokëve të tjerë që ishin aty, Pastaj u
vesh e doli. Aft i ishte shprehur plot urrejtje. Todi
s'ngope, së shpejti kërkoi të shpërthente me llogarë.
nëpër mesazha, duket part i njomë me vepon
e veshë që shpërthente si një trrezë e bllokë de
apo kish t'ndur.
Në çorë, mollë ish shokësuar me lule, qytet
purpurme në të bardha. Në një dritë malle jas
dëbrim, një bllok, Todi ja ngoli sytë për të



NJË
MËNGJES
MAJI

E ëma e zgjoi Todin që me natë.

— Ngreu, bir, i tha, unë do të shkoj në arë.
Kij kujdes e mos u largo nga shtëpia.

Ajo u nis. Todi e dinte se ç'duhej të bënte.


Fërkoi sytë që t'i delte gjumi. Pastaj u vesh e doli. Ajri ish i freskët e plot aromë. Todi s'ngopej së thithuri këtë ajër t'erëndshëm. Larg, nëpër mezhda, dukej bari i njomë nën vellon e vesës që shndrinte si ar nga rrezet e diellit që sapo kish lindur.

Në oborr, molla ish stolitur me lule, ngjyrë purpur me anë të bardha. Në një degë molle kish qëndruar një bilbil. Todi ja nguli sytë këtij

zogu me trup të hollë e me pendë ngjyrë kafe që hapte sqepin e nxirrte tinguj të ndryshëm e të ëmbël.

— Oh, sa bukur! — tha Todi. — Sa i bukur qënka ky mëngjez maji! Dhe iu duk, sikur i tërë trupi i tij u mbush me gjallërinë magjepsëse të natyrës.

Ai shkoi te koteci i pulave. I donte shumë ato. Kur vinin kllloçkën, çdo ditë i shikonte vezët. I dukej diçka e çuditëshme dhe gëzohej pa masë kur zogjtë shponin guaskën e delnin nga



veza. Sa të bukur dukeshin me ato pendë të vogla si push!

Në fillim, sapo iu afrohej, kllloçka ngrinte krahët, kllithte dhe i turrej e egërsuar. Po më pas, kur e shihte se djali i vogël i donte zogjtë dhe u hidhte atyre thërrime buke ajo s'e ngiste më. Ai vinte re se si atyre u formoheshin pendët e u merrnin ngjyrë tjetër.

Kështu mësohej aq shumë me ta sa që kur therrte nëna ndonjë zog, Todit i vinte keq, dhe nuk e hante.

Todi hapi kotecin dhe, duke hedhur gëzhhuta në oborr, thërriti:

— Ti, ti, ti! Tërr!

I pari doli një këndez i madh me pëndë të bukura, si të lyera me vaj, i krekosur, me bisht të lartë e me lafshën flakë të kuqe. Ai mori në sqep një kokërr grurë të veshur dhe i ndolli pulat, ndërsa vetë shikonte se si hanin ato.

Atë çast në rrugë u dëgjua zhurmë makine. Shtëpia, që ish nën rrugë, u drodh. Todi u trondit. Nuk vinin makina në fshatin e tyre. Kjo ndodhte rrallë, vetëm atëhere kur pushtuesit kishin për të vrarë a për të burgosur njeri. Këtë e dinin edhe fëmijët. Prandaj Todi u tremb dhe zuri të mendonte për keq. Ai pa të shkonin me shpejtësi tri makina të mbushura me ushtarë. Ushtarët ishin me helmata dhe automatikët e pushkët i mbanin gati për të qëlluar.

— Do ta kenë pësuar nga partizanët — mendoj Todi. — Po tani ç'do të bëjnë vallë?

Mirëpo zhurma e makinave s'dëgjohej e ai s'mendoj më për ta. U hodhi një dorë tjetër me gëzhuta pulave dhe po shikonte se si ato ziheshin e hanin me oreks.

Papritur porta e oborrit u hap me zhurmë. Djali i vogël ktheu kokën dhe ngriu në vend: në shtëpinë e tij po hynin dy ushtarë gjermanë. Ata ishin trupmëdhej, me mëngë të përveshura e me armë në dorë. Todi për pak do të thërriste t'ëmën, po u kujtua që ajo ish në arë. Hem i erdhi keq që ajo s'ish, hem u gëzua. «Më mirë që s'është — tha me vehte. — Këta do t'i bënin ndonjë të keqe. Po përse erdhën vallë?»

Sapo e panë djalin me pulat, ushtarët trupmëdhej diçka folën midis tyre.

— Zehr gut! ¹⁾ — tha njeri e të dy qeshën dhe iu afruan Todit.

Njeri i foli rreptë. Nga shenjat djali e kuptoi se duhej të ikte. Iku me të shpejtë. U fut në portën e tremit dhe prapa saj po shikonte me ankth ç'do të bënin gjermanët. Këta filluan të rrëmbenin pulat. Pulës që zinin, ja lidhnin krahet dhe e lëshonin për tokë. Ndonjë që desh të fluturonte jashtë, e qëllonin me revolver dhe e vrisnin.

1) Shumë mirë! (gjermanisht)

Një pulë e bardhë u afrua te porta e tremit. Todi e deshte shumë këtë pulë. Ajo bënte vezë më shumë se të tjerat. Ai guxoi dhe e futi brenda pulën e bardhë për ta fshehur nga gjermanët. Po gjermanët e panë dhe e thirrën të vinte tek ata. Todi vajti duke hequr këmbët zvarë. Gjermanët i folën me inat. Njeri e goditi në fytyrë. Todi i shkrepën sytë shkëndija, po s'e bëri vehten të qante. Gjermani tjetër seç tha në gjuhën e tij duke treguar pulat. Të dy e zunë, ja lidhën këmbët me tel dhe e varën ashtu si pulat, me kokë poshtë. Todi ndjeu se një valë gjaku i zbriti poshtë. Pastaj fytyra iu mavios e sytë iu zgurdulluan. Ai bëri të thërriste, po zëri s'i dolli. Mëndjen e humbi dhe s'ndjeu më asgjë. . .

Gjermanët në fillim qeshën me këtë lodër që bënë, por kur panë se djali i vogël i humbi ndjenjat, e lëshuan mbi një tavolinë të vjetër, e cila ndodhej në qoshe të oborrit. Po nuk u bënë më merak për të. Zunë të mblidhnin pulat që ishin të shpërndara në oborr dhe i lidhën varg me tel. Këndezi kish shpëtuar dhe kish hipur mbi degët e mollës. Por e panë edhe atë. Njeri nga ushtarët gjermanë e trembi me një shkarpë. Disa lule e fletë molle ranë përdhe. Këndezi i madh fluturoi në oborr. Gjermani e qëlloi me revolver ashtu në fluturim. Plumbi shkëputi vetëm dy tri pendë të shndritëshme.

Nga tavolina, ku ish i shtrirë Todi, u dëgjua një rënkim i thellë. Pastaj koka e tij u anua dhe krahët iu varën poshtë pa jetë.

Gjermani e kuptoi se plumbi kish goditur trupin e djalit të vogël. Ai i bëri shënjë shokut. Të dy shkuan te tavolina. E panë që djali kish mbaruar, shikuan njeri tjetrin dhe mblodhën buzët. Pastaj, sikur të mos kish ndodhur asgjë, muarën pulat dhe shkuan.



PARTIZANIA Ë VOGËL

Kur isha i vogël pjesën më të madhe të ditës e kaloja tek lëndina e kishës, në rrzëzë të së cilës ndodhej një çezme me ujë të ftohtë e të kulluar. Kjo lëndinë ish qendra e lodrave për fëmijët e fshatit. Ata që ishin më të mëdhenj losnin me çik dhe me futboll, me topa prej lecke. Kurse ne, më të vegjëlit, kishim aty një qoshe që e hiqnim si pjesën tonë.

Një ditë, ne po losnim si ngaherë. Pa prituri në lëndinë zunë të vinin njerëz nga fshati. Bashkë me ta kishte dhe partizanë. Brenda disa minutash lëndina u mbush plot. Shpejt e shpejt vunë nja dy a tri tryeza ngjitur. Një partizan hipi mbi to e foli mjaft. Ai fliste e të tjerët duartrokisnin shpesh. Pastaj mbi tryezë hipën nja tre a katër të tjerë. Lëviznin duar e këmbë dhe seç thoshin herë me inat e herë me

të qeshur. Nuk kuptoja as se çfarë bënin dhe as çfarë flisnin. Veç shihja se të gjithë ata që ishin mbledhur aty herë pas here qeshnin me të madhe.



Një partizan, që më pa se po mundohesha të shikoja, më mori në krahë e më ngriti lart. Atë çast, atje ku, siç mësova më pas, po jepej çfaqje, hipi një partizane e vogël. Kapelën e kish vënë mbi sy e shumë të prirur anash. Fytyrën e kish të bukur, të rrumbullaktë me faqe të kuqe si të kukllave dhe me sy tepër të lëvizshëm.

Ajo shikoi një herë anembanë, buzëqeshi e nisi të këndojë. Zërin e kish të bukur. Në fi-

llim të këngës thosh se kërkonte çetat partizane. Këto vargje:

«Sa e vogël isha, nënë,
Dhe sa shpejt u rrita
Hej, moj nënë hej! . . .»

i mbaj mend fare mirë, ndoshta, se i përsëriste dendur.

Duke kënduar këto vargje, ajo lëviste trupin dhe me duar bënte sikur tregonte sa e vogël kish qenë dhe sa shpejt ish rritur e qe bërë aq sa ish, luftëtare.

Nuk di nëse më pëlqente më tepër kënga apo partizania e vogël. Dëgjoja me ëndje dhe atë çast ç'nuk do të jepja për të qenë në vendin e saj.

— Sa bukur këndon, shejtania! — tha dikush prapa meje.

Unë ktheva kokën të shihja kush qe ai që foli.

Në këtë çast poshtë nga lumi u këmbyen shpejt e shpejt disa krisma pushkësh.

Në lëndinë u bë rrëmujë e madhe.

Partizani im më lëshoi për tokë dhe iku me vrap andej nga u dëgjuan armët. Tok me të vraponin gjithë partizanët tjerë. Edhe partizania e vogël kish rrëmbyer një automatik dhe vraponte si erë. M'u duk shumë trime, ashtu duke vrapuar.

Fshatarët u shpërndanë nëpër shtëpitë e tyre. Shtëpia ime që afër lëndinës kështu që unë pas pak u gjenda në prehrin e nënës dhe nisa t'i tregoja për ato që kisha parë. Atë çast u dëgjua një trokitje e fortë në portën e jashtme.

Nëna më la mënjanë dhe dolli në oborr.

Pastaj u kthye në dhomë me tre partizanë që mbanin në duar një njeri të plagosur. Koka i qe varur poshtë si pa jetë, kapela i kish rënë dhe flokët i qenë çpleksur.

Unë, sapo e pashë, brofa në këmbë dhe klitha:

— Ah, partizania e vogël. E shkreta, sa bukur këndonte te lëndina!

Dhe m'u mbushën sytë me lotë.

Njeri nga partizanët, një burrë i thinjur me një palë mustaqe gjer në vesh, m'u përgjegj:

— Po, biro, po, partizania e vogël është. Ajo luftoi si trimëreshë dhe u plagos. Po ne do të bëjmë çmos që të shërohet përsëri dhe sa më parë.

Si tha kështu zbriti poshtë në bodrum bashkë me nënën. Dy partizanët e tjerë, duke mbajtur me kujdes luftëtaren e plagosur, e ndoqën pas.

Desha të zbres edhe unë po nuk më lanë.

— Mos, biro, se do t'i mjekojnë plagën, — më tha nëna.

Pasi e mjekuan, partizanët ikën dhe erdhën të nesërmen përsëri.

Kur ikën ata, unë e hapa me kujdes qepëngjinë e bødruimit dhe me druajtje futa kokën brenda. Partizanen e vogël e kish zënë gjumi. U mata të ikja, po qepëngjia krisi dhe ajo u zgjua.

U zura ngushtë.

— Do ujë? — e pyeta me që nëna më kish thënë se ajo gjithnjë kërkonte ujë.

— Jo — tha — ujë kam, po ti hajde këtu.

S'po vendosja dot.

— Hajde, pra, mos kij turp.

— Po ti s'duron dot, se je e plagosur...

— Jo, jo s'është e vërtetë! Ti do të më bësh të shërohem më shpejt.

— Unë?

— Po, po, ti!

Duke i zvaritur këmbët, vajta pranë saj.

Ajo zgjati dorën e më përkëdheli flokët.

Unë i thashë:

— Kush të plagosi ty?

— Fashistët!

— Unë do t'i vras ata fashistët!

— Ha! ha! ha! E me-se do t'i vrasësh?

— Kam fshehur një bombë e ca fishekël

— Të lumtë! Po pse do t'i vrasësh?

— Se të plagosën ty!

— Po përse më dashke kaqë fort?

— Sepse për ty thonë se je trime e goj-
ëmbël.

Asaj iu bë qejfi.

— Ashtu thonë? E ku e di ti?

— I dëgjova partizanët që flisnin për ty, kur
duallën prej kësaj dhome. Ajo nxori që poshtë
jastëkut një kapele me yll të kuq dhe ma vuri
në kokë.

— Sa i bukur dukesh kështu, o trim i vo-
gël! — tha e më përkëdheli prap me ato duart
e saj të vogla e të buta. — Si të quajnë?

— Pepi. Po ty?

— Mua më quajnë Rita.

— Po ty të thërresin «Partizane e vogël»!
— thashë i habitur.

— Ashtu më thërresin, po emrin e kam
Rita.

Heshta, se s'dija ç'të thosha. Pastaj, si me
turp, e pyeta:

— Po ti kur u rrite? Kur dole partizane?

Ajo buzëqeshi.

— Jo, mor pëllumb, unë më parë u rrita e
pastaj dola partizane.

— Po pse këndoje «Sa e vogël isha nënë,
dhe sa shpejt u rrita»?

Rita qeshi përsëri.

— Se ashtu është kënga — tha — Pastaj,
unë u rrita vërtet, po jo me trup. . .

Atë kohë s'kisha si ta kuptoja këtë rritje, për të cilën fliste partizania e vogël.

Ajo më vështronte me ëmbëlsi e vazhdonte të më përkëdhelte.

— Po ku e dëgjove këngën ti? Ishe te lëndina, kur këndoja unë?

— Isha, posi!

— Ashtu?

— E di ç'thonin fshatarët për ty? «E paska zërin bilbil!»

— Po ti si thua?

— Edhe unë ashtu them. Ti këndoje aq mirë sa unë e mësova menjëherë këngën tënde. Dhe ja mora me zë të lartë:

«Sa e vogël isha, nënë. . .»

— Ah, shejtani i vogël! Sa shpejt i mësoke këngët! Pa këndo ndonjë këngë tjetër, apo s'di?

Ja këndova asaj gjithë këngët që kisha mësuar.

Partizania e vogël dëgjonte dhe kur mbaroja, vinte buzën në gaz e më lavdëronte.

— Ua, sa bukur! Ti këndoke si partizan!

— Po kur të rritem edhe ca, unë do të bëhem partizan!

— Vërtet?!

— Vërtet, posi, me gënjeshtër thua ti?

Atë çast më thërriti nëna. Unë dolla.

Për çdo ditë kaloja orë të tëra me Ritën, partizanen e vogël e të plagosur. Mezi e prisja çastin, që të shkoja tek ajo. Dhe ikja vetëm kur më thërriste nëna.

Sa gjëra të bukura më tregonte Rita! Më fliste për partizanët, më mësonte këngë, më tregonte përralla të çuditëshme.

Nganjëherë bënte shaka me mua, më ngacmonte si vëllanë e saj, të cilit i ngjisja shumë.

Mirëpo çastet e këndëshme janë të shkurtrëta. Një ditë prej ditësh partizanen e vogël erdhën e muarën shokët e saj.

Unë zura të qaja. Një partizan babaxhan më vuri dorën mbi kokë e më tha:

— Dëgjo këtu, o trim. Shogën Rita do ta marrim, nuk mund ta lemë këtu, se mos vijnë armiqtë. Do ti që ta mundojnë e ta vrasin atë?

Me këto fjalë babaxhani ma zuri gojën.

Rita më puthi disa herë.

— Ti më hyre në zemër, o pëllumb — tha ajo. — Unë të dua shumë e nuk do të të harroj kurrë, ta dish! Do vij prap në shtëpinë tuaj, ja të shohësh!


Dhe e ndihmuar nga shokët hipi në një kalë të kuq.

E ndoqa me sy gjersa u largua dhe isha i bindur se ajo do ta mbante fjalën.

Po s'erdhi më. Kushedi nga vajti e luftoi më pas.

Nuk di nëse rron tani partizania e vogël, që e desha aq shumë.

Sidoqoftë, edhe sot, kur dëgjoj këngën e saj, unë e kujtoj me mall atë. Dhe ky kujtim bën pjesë në kujtimet më të dashura të femënisë sime.



BARI
I
GRABITUR

Raqi nuk doli të loste me shokët, siç bënte përherë. Më mirë të them se nuk kish si të delte. Atë ditë koha ish shumë e keqe. Bënte një cingërimë që të përcëllonte fytyrën, dhe akulli i bardhë si kristal ish ntrashur një gisht.

Me që s'kish ç'të bënte, Raqi vajti në ahurin e bagëtive. Ai kujdesej gjithmonë për 'to. I krihte e u hidhte për të ngrënë. Sidomos për Bushikun — kështu e quante ai demin e vogël — atë nuk e zinte gjumi. Bushikun nuk ja besonte askujt. E ushqente veç të tjerëve dhe ja mprichte brirët me thikë që, kur të rritej edhe ca, t'i mundte të gjithë demat e fshatit.

Kjo ish dëshira e tij më e madhe!

Ata sikur merreshin vesh midis tyre. Kur ngrinte kokën Bushiku, Raqi e kuptonte se ai desh të hante. Po edhe kur djali ja tundte dorën, demi i vogël e merrte vesh se s'duhej të kërkonte më.

Sapo Raqi vajti në ahur, Bushiku ngriti kokën lart.

— Bushik, si i ke punët? A je bërë më i fortë? Të hahet? Do të të sjell një krah të mirë me bar, dëgjon? Vetëm ti të mos më turpërosh e t'i mundësh tërë demat e fshatit! — tha Raqi duke ja fërkuar qimet e shkurtëra të zverkut dhe duke ja provuar majat e brirëve.

Pastaj, pasi e fshiu ahurin dhe e pastroi grazhdin nga mbeturinat, ai vajti të merrte bar.

Kur iu afrua mullarit, ç'të shihte! Një karvan me mushka të mëdha e të ngarkuara kapicë me barin e tyre, kish mbushur rrugën. Një grup ushtarësh italianë, sado që ish ftohtë dhe fryma që nxirrnin nga goja ngrinte menjëherë, loznin si fëmijë. Nxirrnin duart përpara dhe hapnin gishtrinjtë. Këtë punë e bënin me shumë shkathtësi e duke thirrur:

- Due!
- Quatro!
- Cinque!
- Sei! ¹⁾

1) Italisht: Dy! Katër! Pesë! Gjashtë!



Me sa dukej oficeri i tyre diku kish vajtur, dhe gjersa të kthehej ai, ata e shkonin kohën, duke luajtur çift a tek dhe qeshnin me të madhe.

Sidomos kjo e qeshura e tyre e xhindosi djalin e vogël.

Ai i shikonte mushkat e ngarkuara, të vargosura njera pas tjetrës, dhe buza i dridhej. Mënt ja shkrepiti të qariti me zë, kur vuri re se mushkat e mbushnin gojën me bar dhe përty-peshin me shije!

Sa me mundim e kishin mbledhur këtë bar! Ai vetë kish vajtur bashkë me t'ëmën arë më arë e mezhde më mezhde. Këtë punë e kishin vazhduar ditë të tëra, gjithë beharin. Kushedi sa gjëmbe i kishin hyrë nëpër duar! Kushedi sa herë u ishin gërvishtur këmbët! Po

këto ai i kish duruar, sepse, më në fund, e din-
te që demi i tij do të kishte ç'të hante në di-
mër.

Kurse tani ushtarët e huaj, pa pyetur
fare për të, ja kishin rrëmbyer barin. Me se do
ta ushqente Bushikun e tij?

Iu duk sikur e shihte kafshën e gjorë koc-
kë e lëkurë, sa që mezi çapitej. Iu duk sikur ai
kish frikë jo më nga demat e tjerë, po edhe
nga viçat! Dhe më në fund iu duk sikur ai kish
mbyllur sytë e s'lëviste më, ish shtrirë e kish
ngordhur. . .

Atë ças një lëmsh i madh ja zuri grykën
dhe s'e linte as të fliste as të merrte frymë.

Ai kish vetëm një dëshirë: të hakmerrej!

Ah, sikur të ish më i madh! Do të sulej e
do të futej në mes të ushtarëve, do t'u jepte një
grusht njerit, një shuplakë tjetrit, një shkelm
atij të tretit dhe do t'ua tregonte qejfin.

Po tashti? Tani ç'duhej bërë? Sidoqoftë
nuk duhej ndenjtur duarkryq.

Të vinte e t'iu thosh ushtarve se nuk ki-
shin tjetër bar dhe bagëtia do t'u ngordhnin
për të ngrënë? T'u lutej t'ja kthenin barin?
Jo! N'asnjë mënyrë! Atyre jo vetëm që s'do t'iu
vinte keq për të, por, me siguri do ta tallnin. Të
vinte t'i thosh të jatit? Po ç'mund të bënte ai?
Ata kishin edhe pushkë. Apo t'ia vrisnin ba-
banë, siç kishin vrarë të jatit e Ndrios! Këtë

ai s'mund ta bënte kurrë! Jo, nuk ish aq bu-
dalla.

Vetë, vetë diç duhej të bënte!

U mendua një copë herë e më në fund e
gjeti: t'u vinte zjarrin mushkave! Ushtarët s'e
kishin mendjen fare. . . bari ish i thatë. . .

«Tamam kështu duhet bërë» tha me vehte
dhe, pasi shikoi me kujdes se mos e kishin dik-
tuar, u kthye prapë me të shpejtë, pa e vënë
re italianët.

Me marifet e mori kutinë e shkrepes në
dollap dhe dolli nga deriçka. Vjedhur, duke
patur gjithmonë sytë nga ushtarët që akoma
po loznin, iu afrua mushkës së parë, e cila po
hante nga barra e saj.

E pështeti kutinë në barin e thatë dhe fër-
koi një fije në të. Duart i dridheshin, ca nga të
ftohtit, ca nga nxitimi dhe fija e parë i shko
kot. Po e dyta shkrepë me një të fërkuar dhe
bari mori sakaq, duke kërcitur.

Raqi kaq desh. . . Iku me vrap. Tani dy-
shonte vetëm se a do të merrnin zjarr të gjitha
mushkat? U ngjit me të shpejtë lart, në odë, që
të shihte ç'bëhej. Deri sa vajti ai në dritare, ba-
ri i mushkës, që i vuri zjarr, kish marr i tëri.
Mushka e madhe dukej tamam si një kashtare.
Ajo, e trembur, u zbraps me rrëmbim. Të gjitha
u frikësuan dhe, pasi nuk kishin nga të shko-

nin, u bënë grumbull. Mori zjarr edhe bari i të tjerave.

Kish zënë të vinte era curmë nga lëkura e mushkave, që digjeshin. Ushtarët vinin rrotull pa patur ç'të bënë. Bërtisnin e i kanoseshin njeri tjetrit se cili e pati cigaren ndezur.

Veç të ishte atje e të bëje sehir! Raqi i shikonte dhe thosh me vehte: «Hëde, hë, ja, kështu grabitet bari i botës!»

PASQYRA E LËNDËS

	Faqe
Mësuesi im i parë	3
Rruga e jetës	9
Një mëngjez maji	14
Partizania e vogël	20
Bari i grabitur	29

Redaktor: Adhnan Mërnadi
Korrigjor: Ismet Kallaku
Përkthyes: Ismet Kallaku
Redaktor teknik: Adhnan Mërnadi

Redaktore: Adelina Mamaqi
Korektor letrar: Reshat Këllici
Piktor: Ibrahim Shehu
Redaktor teknik: Adem Lita

Tirazhi 5000 kopje Format 76 x 100/32 Stash: 2204-65

Shtyp N.I.Sh. Shtypshkronjave «MIHAL DURI» — Tiranë 1966